



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 893 / Prot.  
2

Tiranë, më 10/07 2024

VENDIM

Nr. 15, datë 10/07 2024

PËR

**“MIRATIMIN E TARIFAVE DHE PAGESAVE PËR MARRJEN E TITULLIT  
“PROFESOR I ASOCIUAR” DHE “PROFESOR”, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Mbështetur në nenin 3, pika 3, gërma ç, në nenin 49, pika 4 dhe në nenin 61 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në VKM nr. 112, dtë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, të ndryshuar, në Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, të ndryshuar, në Statutin e Universitetit të Arteve, neni 48 dhe 67, në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA) të Universitetit të Arteve”, miratuar me VSA nr. 18, datë 11.04.2024, në Vendimin nr. 92, datë 09.07.2024 “Për miratimin paraprak të tarifave dhe pagesave për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, në Universitetin e Arteve”, Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve, në mbledhjen e datës 10.07.2024, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Pjesëmarrja në komisionin për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” të vlerësohet si më poshtë:
  - Kryetar i jurisë: 1 (një) x 20 orë x 1.410 l/orë = 28.200 lekë
  - Anëtar i jurisë: 4 (katër) x 15 orë x 1.410 l/orë = 84.600 lekë
2. Shpenzimet për anëtarët e jurisë me vendbanim jashtë Tiranës apo jashtë vendit të përballohen nga vetë kandidati që kërkon të promovohet, sipas procedurave përkatëse administrative.
3. Kryetari, anëtarët dhe sekretariati i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA) të shpërblehen në masën e një page mujore për punën vjetore, pavarësisht numrit të mbledhjeve.




4. Të përcaktojë tarifën e aplikimit në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për fillimin e procedurës për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” apo “Profesor”, për aplikantët që nuk janë personel me kohë të plotë në UART.
5. Të përcaktojë shpenzimet e tjera administrative në vlerën 7.200 (shtatëdhjetë e dy) lekë, për procedurën e marrjes së titullit “Profesor i asociuar” apo “Profesor”, për të gjithë aplikantët.
6. Të përcaktojë tarifën e shërbimit (kosto totale) në vlerën 120.000 (njëqind e njëzet mijë) lekë, për ndjekjen e procedurës për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” apo “Profesor”, për aplikantët që janë personel me kohë të plotë në UART.
7. Të përcaktojë tarifën e shërbimit (kosto totale) në vlerën 170.000 (njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, për ndjekjen e procedurës për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” apo “Profesor”, për aplikantët që nuk janë personel me kohë të plotë në UART.
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UART, njësitë kryesore të UART, Drejtoria Ekonomike si dhe DBNJ/ISJP-A.
9. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**


**BORDI ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Lavdrim SAHITAJ**  
  
\_\_\_\_\_  
(Kryetar)


**Prof. Besnik Bisha**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Jeton SHEHU**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI**

  
\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Ergis SEFA**

\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Lorenc VANGJELI**

\_\_\_\_\_  
(Anëtar)

**Vladimir LLAKAJ**

\_\_\_\_\_  
(Anëtar)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 893/Prot.

Tiranë, më 09 . 07 .2024

VENDIM

Nr. 92 , datë 09.07.2024

PËR

**“MIRATIMIN PARAPRAK TË TARIFAVE DHE PAGESAVE PËR MARRJEN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR” DHE “PROFESOR”, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 3, pika 3, gërma ç, në nenin 38 dhe në nenin 61 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, në VKM nr. 112, dtë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, të ndryshuar, në Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, të ndryshuar, në Statutin e Universitetit të Arteve, në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA) të Universitetit të Arteve”, miratuar me VSA nr. 18, datë 11.04.2024 dhe pasi shqyrtoi e diskutoi mbi relacionin përmes së cilës përcillet propozimi për tarifën dhe pagesat që lidhen me procedurën e promovimit të personelit akademik, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Pjesëmarrja në komisionin për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” të vlerësohet si më poshtë:
  - Kryetar i jurisë: 1 (një) x 20 orë x 1.410 l/orë = 28.200 lekë
  - Anëtar i jurisë: 4 (katër) x 15 orë x 1.410 l/orë = 84.600 lekë
2. Shpenzimet për anëtarët e jurisë me vendbanim jashtë Tiranës apo jashtë vendit të përballohen nga vetë kandidati që kërkon të promovohet, sipas procedurave përkatëse administrative.



3. Kryetari, anëtarët dhe sekretariati i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA) të shpërblehen në masën e një page mujore për punën vjetore, pavarësisht numrit të mbledhjeve.
4. Tarifa e aplikimit për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” apo “Profesor”, për aplikantët që nuk janë personel me kohë të plotë në UART, të jetë 50.000 lekë.
5. Shpenzimet e tjera administrative për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” apo “Profesor”, për të gjithë aplikantët, të jenë 7.200 lekë.
6. Tarifa e shërbimit (kosto totale) për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” apo “Profesor”, për aplikantët që janë personel me kohë të plotë në UART, të jetë 120.000 lekë.
7. Tarifa e shërbimit (kosto totale) për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” apo “Profesor”, për aplikantët që nuk janë personel me kohë të plotë në UART, të jetë 170.000 lekë.
8. Ky vendim t’i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve.
9. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Asoc. Dr. Artan IBËRSHIMI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA



Prof. Asoc. Albes FUSHA



Prof. Asoc. Genci FUGA



Sindi ZDRAVA (Studente FM)

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI



Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI



Erlind FUSHA (Student FAB)







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
REKTORI

Nr. 893 Prot.

Tiranë, më 08.07.2024

Lënda: Për propozimin e tarifave dhe pagesave mbi procedurën e promovimit të personelit akademik si dhe pagesave për komisionet e angazhuara në zgjedhje

**SENATIT AKADEMIK, UART**

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT, UART**

**Për dijeni: ADMINISTRATORIT, UART**  
**Znj. Alma SINANAJ**

*Të nderuar,*

Në zbatim të nenit 60 dhe 61 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Statutit të UART, i ndryshuar, si dhe të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA) të Universitetit të Arteve”, miratuar me VSA nr. 18, datë 11.04.2024, në Universitetin e Arteve është përmblytur procedura e promovimit të personelit akademik përsa i përket dhënies së titujve “Profesor i asociuar në arte” dhe “Profesor në arte”. Propozimet e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik për dhënien e titujve si dhe vendimet e Senatit Akademik për dhënien e titullit për çdo kandidat i janë përcjellë Bordit të Administrimit të UART, me shkresën nr. 791 prot., datë 20.06.2024.

Neni 36 i Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA) të Universitetit të Arteve”, me titull “*Efektet financiare dhe shpërblimi i anëtarëve*”, nxjerr si detyrë përcaktimin e disa çështjeve që lidhen me tarifa dhe pagesa.

Për këtë arsye, në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, pas një procesi të gjatë konsultimesh dhe diskutimesh, vlerësoj të paraqes për vlerësim dhe më tej për miratim, para Senatit Akademik, Bordit të Administrimit dhe Administratorit propozimet e KPPA si më poshtë:







1. Në lidhje me përcaktimin e pagesës së anëtarëve të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik për punën e kryer (neni 36, pika 1 e Rregullores):

- Kryetari dhe anëtarët e KPPA të shpërblehen në masën e një page mujore për punën vjetore, pavarësisht numrit të mbledhjeve.

2. Në lidhje me përcaktimin e pagesës së sekretariatit të KPPA për punën e kryer (neni 36, pika 2 e Rregullores):

- Sekretariati i KPPA të shpërblehet në masën e një page mujore për punën vjetore, pavarësisht numrit të mbledhjeve.

Ky Komision përbëhet nga një numër i madh anëtarësh (7 anëtarë) dhe sekretarësh (3 sekretarë) dhe procedurat që ndjek ky komision për dhënien e titujve (sqarojmë se ky Komision angazhohet si për dhënien e titujve “Profesor”/“Profesor i asociuar”, ashtu edhe “Profesor në arte”/“Profesor i asociuar në arte”), parashikojnë realizimin e një numri të madh mbledhjesh. Mbi bazën e përllogaritjeve është vlerësuar se efekti financiar për institucionin do të ishte i konsiderueshëm nëse anëtarët dhe sekretarët do të paguheshin për çdo mbledhje, si për shembull sipas VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisive të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar. Për këtë arsye, është propozuar që pagesa të jetë në masën e një page mujore.

3. Në lidhje me përcaktimin e pagesës së kryetarit dhe anëtarëve të jurisë për vlerësimin e dosjes së kandidatit për titullin akademik të kërkuar (neni 36, pika 3 e Rregullores):

- Për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” apo “Profesor”, kosto e kryetarit të jurisë: 1 (një) x 20 orë x 1.410 l/orë = 28.200 lekë
- Për marrjen e titullit “Profesor i asociuar” apo “Profesor”, kosto e anëtarëve të jurisë: 4 (katër) x 15 orë x 1.410 l/orë = 84.600 lekë

Për përcaktimin e ngarkesës së punës, të shprehur në orë, është marrë për referencë Udhëzimi nr. 29, datë 10.09.2018 i MAS “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”. Në kreun II, pika 12, gërma “gj”, parashikohet ngarkesa për pjesëmarrje në juri doktrate, e cila për kryetarin e jurisë përcaktohet në 15 orë, ndërsa për anëtarët në 10 orë. Duke konsideruar se vlerësimi i dosjeve për dhënien e titujve kërkon një anagzim më të madh, është vlerësuar rritja e orëve të punës me 5 orë më shumë për secilën kategori, duke dale në përfundimin 20 orë për kryetarin dhe 15 orë për anëtarët.

4. Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për anëtarët e jurisë me vendbanim jashtë Tiranës apo jashtë vendit (neni 36, pika 4 e Rregullores):

- Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit përballohen nga vetë kandidati që kërkon të promovohet.





Mundet që në jurinë e kandidatit që kërkon të promovohet të angazhohen persona që kanë vendbanim jashtë qytetit të Tiranës apo që jetojnë përtej kufijve. Siç dihet, pjesëmarrja fizike e tyre ka një kosto të lartë, që lidhet me shpenzimet e transportit, akomodimit si dhe të dietës. Në këtë rast, është vlerësuar që këto shpenzime të përballohen nga vetë kandidati duke çuar në rritjen e kostos totale të shërbimit të kandidatit që kërkon të promovohet. UART do të mbulojë fillimisht shpenzimet, të cilat do t'i faturohen në fund kandidatit që kërkon të promovohet, sipas procedurave përkatëse administrative.

Është vlerësuar edhe mundësia e rritjes së kostos totale të shërbimit për të gjithë kandidatët, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të anëtarit të jurisë së kandidatit me vendbanim jashtë Tiranës apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por si përfundim është gjykuar se kjo do të ishte në disavantazhin e kandidatëve të tjerë, të cilët angazhojnë në jurinë e tyre vetëm anëtarë me vendbanim në Tiranë.

5. Në lidhje me përcaktimin e tarifës së aplikimit, shpenzimet administrative si dhe tarifën për shërbimin e kryer (kosto totale) për kandidatët që kërkojnë të promovohen për fitimin e një titulli akademik (neni 36, pika 5 e Rregullores);

- Për marrjen e titullit “Profesor i asociuar”/“Profesor”, për aplikantët që janë personel me kohë të plotë në UART:
  - Shpenzimet administrative të jenë: 7.200 lekë
  - Tarifa për shërbimin të jetë: 120.000 lekë
- Për marrjen e titullit “Profesor i asociuar”/“Profesor”, për aplikantët që nuk janë personel me kohë të plotë në UART:
  - Shpenzimet administrative të jenë: 7.200 lekë
  - Tarifa e aplikimit të jetë: 50.000 lekë
  - Tarifa për shërbimin të jetë: 170.000 lekë

Gjithashtu, bazuar në nenin 131 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Urdhrin nr. 101, datë 13.03.2024 të MAS “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, në Universitetin e Arteve, më datë 21 Qershor 2024 janë mbajtur zgjedhjet për autoritetet e reja drejtuese dhe Senatit Akademik. Me qëllim të mbarëvajtjes së gjithë procesit zgjedhor, janë ngritur Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) si dhe Komisioni i Apelimit (KA).

Mbështetur në nenin 22, pika 9 të Statutit të UART si dhe në Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024, propozojmë që:

- Kryetari, anëtarët dhe sekretari i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) të Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) si dhe të Komisionit të Apelimit (KA), personel akademik apo administrativ, të shpërblehen në masën e një page mujore. Pagesa në vlerën e një page mujore është e përcaktuar në mënyrë taksative nga aktet e mësipërme, sikundër rrjedh edhe nga praktika e viteve të kaluar.



- Studentët, anëtarë në KIZ apo KZF, të shpërblehen në masën e një page mujore të punonjësit mësimor nga kategoria asistent-lektor.

Bazuar në Vendimet përkatëse për konstituimin e këtyre Komisioneve, më poshtë anëtarësia për secilin Komision:

- ***Komisioni Institucional i Zgjedhjeve:***
  1. Z. Orges Malaj
  2. Z. Shpëtim Kërçova
  3. Znj. Suela Agolli
  4. Znj. Adela Kusuri
  5. Znj. Sara Caca (studente)
  6. Z. Redjan Mulla
- ***Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Muzikës***
  1. Znj. Nereida Fico
  2. Z. Lorenc Treska
  3. Z. Fabjol Aliaj (student)
  4. Znj. Ardita Bufaj
- ***Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Arteve të Bukura***
  1. Z. Artan Buca
  2. Z. Genc Përmeti
  3. Z. Erlind Fusha (student)
  4. Z. Harri Aleksi
- ***Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Artit Skenik***
  1. Znj. Rozina Kostani
  2. Z. Ervin Meniko
  3. Z. Dorjan Kodra (student)
  4. Z. Eno Milkani
- ***Komisioni i Apelimit***
  1. Znj. Elvina Koçillari
  2. Z. Petraq Papa
  3. Z. Artur Selmani
  4. Znj. Fatmira Keta

Për sa më sipër, kërkohet nga Senati Akademik të marrë në shqyrtim dhe të vendosë paraprakisht propozimet lidhur me tarifatat dhe pagesat për procedurën e promovimit të personelit akademik ndërsa Bordi i Administrimit të miratojë pagesat për anëtarët e komisioneve të angazhuar në zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese në UART, sipas këtij relacioni.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

  
**REKTORI**  
  
**Prof. Kastriot CAUSHI**

